



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr.134, Datë 06.09.2017

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
“OST”SH.A.,NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16, 37 pika 2 gërma ‘b’, 38, 53 dhe 58 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë operatori i sistemit të transmetimit “OST”sh.a.,në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a., me shkresën nr.dl.3864 Prot., datë 12.07.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.
- Neni 58 i Ligjit, nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon që “Para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.”
- Me vendimin nr.43, Datë 15.03.2017, Bordi i ERE ka vendosur Miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike “OST” sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC.

Aplikimi i shoqërisë “OST” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- gërma “a” (të dhënat për aplikim), plotësuar;
- gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) plotësuar;
- gërma “c” (të dhëna për aplikuesin) plotësuar;

Neni 9, pika 2:

- gërmat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti), plotësuar;
- gërma “c” (vërtetimi i rregjistrimit nga QKB) plotësuar;
- gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë) plotësuar;
- gërma “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë) plotësuar;
- gërma “f” Marrëveshje Koncesioni ose autorizimi nga KM në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës. (kjo pikë e rregullores nuk gjen zbatim për këtë aktivitet)
- gërma “g” dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar). Plotësuar (Subjekti ka depozituar në ERE çertifikatat përkatëse të pronësisë)

Neni 9, pika 3:

- gërma “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave) : Plotësuar
- gërma “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit): Plotësuar
- gërma “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) Plotësuar;
- gërma “d” (vërtetimin e pagesës së rregjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s) Plotësuar.

Neni 9, pika 4.5 Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike

- gërma “a”. Të dhëna për linjat e transmetimit – Plotësuar
- gërma “b”. Të dhëna për n/st e sistemit të transmetimit - Plotësuar.
- gërma “c”. Të dhëna për konsumatorët dhe përdoruesit e lidhur në sistemin e transmetimit -Plotësuar.
- gërma “d”.Të dhëna për energjinë që parashikohet të transmetohet - Plotësuar.
- gërma “e”. Diagrama e sistemit të transmetimit që tregon elementet ekzistues dhe ata të perspektivës në format A1 – Plotësuar
- gërma “f”. Planet e investimeve për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit – Plotësuar
- gërma “g”. Lista e të punësuarve, profesioni, formimi – Plotësuar

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit “OST” sh.a., në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike për një afat 30 (tridhjetë)-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë OST sh.a për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI